

**RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT SHUMËVJEÇAR TË POLITIKËS
SPEKTRALE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projekt vendimi “Për miratimin e programin shumëvjeçar të politikës spektrale”, është propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 22 të ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ky projekt-vendim, synon miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe ka për qëllim realizimin e planifikimit strategjik dhe harmonizimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, për të garantuar një përdorim efikas të spektrit të frekuencave në përputhje me politikat e BE-së për përdorimin e spektrit të frekuencave, në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive. Projekt vendimi synon gjithashtu transpozimin e vendimit të BE-së 243/2012/EU për miratimin e një programi shumëvjeçar për spektrin radio.

Projekt vendimi bën një plotësim të rëndësishëm në legjislacionin për spektrin e frekuencave si një pasuri kombëtare, burim i fundëm natyror me vlerë ekonomike, sociale e kulturore.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE**

Projekt-vendimi është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2020, dhe vjen si nevojë e përmirësimit e plotësimit të kuadrit nënligjor, në zbatim të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare. Projekt-vendimi është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) për miratim në tre mujorin e dytë të vitit 2020.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Spektri i frekuencave është burim natyror i fundëm. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtare dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Përcaktimi i qartë i politikave spektrale mbi përdorimin në të ardhmen e brezave të caktuar të frekuencave është me rëndësi për zhvillimet e vendit dhe orientuese për investimet dhe teknologjite që përdorin spektrin e frekuencave.

Në kontekstin e rritjes së shpejtë të trafikut të të dhënave me brez të gjerë dhe të rëndësisë ekonomike, industriale dhe sociale të ekonomisë dixhitale, zgjerimi i kapacitetit të rrjeteve të komunikimit elektronik pa tel është bërë një domosdoshmëri. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të spektrit të frekuencave për keto zhvillime është me rëndësi për përmbushjen e kërkesës në rritje për trafikun e të dhënave me brez të gjerë dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve inovative të komunikimit digjital ku po mbështeten gjithnjë e më shumë zhvillimet e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Planifikimi strategjik i frekuencave duhet t'i përgjigjet gjithashtu zhvillimit teknologjik me spektër të gjerë si në fushën e kërkimit shkencor, shërbimeve të transportit, sistemeve inteligjente të transportit detar, hekurudhor, rrugor, ajror, sistemeve të energjisë, komunikimet satelitore, etj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projek-vendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të nenit 5 të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 22, të ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt-vendimi transponon gjerësisht Vendimin nr. 243/2012/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 14 mars 2012, mbi krijimin e programit shumëvjeçar të Politikës së Spektrit Radio, CELEX nr. 32012D0243. Gjithashu projektvendimi është në harmoni me Vendimin nr. 2017/899/EU të Bashkimit Europian të datës 17.5.2017 mbi përdorimin e brezit të frekuencave 470-790 MHz në BE që përcakton 30 qershorin 2020 si afat për lirimin e brezit 694-

790 MHz nga përdorimet e transmetimeve radiotelevizive dhe si afat maksimal 30 qershorin 2022.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi, synon miratimin e një dokumenti politikash spektrale shumëvjeçare që përcakton objektivat strategjike në lidhje me administrimin dhe planifikimin e spektrit të frekuencave për shërbimet civile.

Dokumenti është i përbërë nga 17 nene dhe shoqërohet me një plan veprimi për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në të. Në veçanti projekt propozimi bën disa plotësime të nevojshme si më poshtë:

Në nenin 1, përcaktohet objekti dhe qëllimi i dokumentit për realizimin e planifikimit strategjik të frekuencave.

Në nenin 2, jepet fusha e zbatimit që përfshin përdorimin e spektrit për qellime civile në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive duke përfshirë fushat e mbrojtjes dhe sigurisë publike.

Në nenin 3, jepen përkufizimet duke dhënë një referencë me ligjin për komunikimet elektronike dhe disa plotësime.

Në nenin 4, kemi përcaktimin e parimeve të përgjithshme rregullatore për spektrin e frekuencave në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive, ku si parim i parë vjen zbatimi i një sistemi autorizimi apo licensimi sa më të përshtatshëm dhe të thjeshtuar, në mënyrë që të garantohet maksimalisht fleksibiliteti dhe eficienta në përdorimin e spektrit të frekuencave në këto fusha.

Në nenin 5, janë dhënë objektivat strategjike për politikën e spektrit të frekuencave që synojnë nxitjen e administrimit dhe përdorimit eficient të spektrit radio, për të përbushur më mirë kërkesën në rritje për përdorim të frekuencave, me vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike.

Në nenin 6, kemi disa përcaktime për përmirësimin e eficientës së përdorimit të spektrit duke orientuar nxitjen e përdorimit të përbashkët të spektrit të frekuencave për të mbështetur zhvillimin e teknologjive ekzistuese dhe të reja.

Në nenin 7, për konkurrencën bëhen disa plotësime të rëndësishme në kuadrin ligjor për garantimin e konkurrencës. Kështu në këtë nen sipas praktikës evropiane orientohet që, kur është e përshtatshme, të vendoset kufizim i sasisë

së spektrit radio për të cilin mund të lëshohen të drejtat e përdorimit për një kompani, ose përcaktim kushtesh për këto të drejta përdorimi me qëllim shmangien e grumbullimit të tepërt apo shtrembërimin e konkurrencës si dhe krijimin e pozitës dominuese.

Në nenin 8, jepet përdorimi aktual i frekuencave dhe mënyra e ndarjes së brezave nënbrezave referuar planit kombëtar të frekuencave. Një informacion mbi përdorimin dhe shpërndarjen aktuale të brezave me interes të lartë për shërbimet e lëvizshme dhe ato numerike është dhënë në aneksin e dokumentit.

Në nenin 9, parashikohen masa për krijimin e spektrit të nevojshëm e të mjaftueshëm për shërbimet broadband pa tel (të lëvizshëm) si dhe jepet orientim për dhënien e autorizimeve për spektrin aktual të lirë. Një çështje e rëndësishme në këtë nën ka të bëjë me planifikimin për lirimin e spektrit të digjital dividend 2, ose brezi 700 MHz.

Brezi i frekuencave 700 MHz, ose i njohur si Digital Dividend 2 (DD2) është shumë i rëndësishëm për sigurimin e mbulimit universal, veçanërisht për zonat me sfida ekonomike, të tilla si zonat rurale, malore ose të largëta, të paracaktuara në përputhje me fushat që janë prioritet kombëtar, duke përfshirë rrugët kryesore të transportit tokësor, dhe për përdorim të brendshëm dhe për komunikim të gjerë si pajisje –pajisje (M2M / IoT).

Në nivel ndërkombëtar, për Rajonin 1, në të cilin bën pjesë edhe Shqipëria, Radio Rregulloret e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) të miratuara nga Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit në vitin 2015 parashikojnë alokimin e brezit 694-790 MHz, për shërbime të transmetimit radioteleviziv dhe për shërbime të lëvizshme (përveç shërbimit aeronautik), mbi një bazë bashkëprimare/parësore. Brezi i frekuencave 470-694 MHz ("brezi nën-700 MHz") mbetet ekskluzivisht i ndarë për shërbimin e transmetimit në baza primare dhe për përdorim pa tel të PMSE në një bazë dytësore.

Në shumë vende të BE-së, por dhe në rajon janë ndërmarrë hapa për lirimin e brezit 700 MHz nga transmetimet televizive dhe vënia në dispozicion e saj për rrjetet e së ardhmes 5G. Në vendet e Bashkimit Europian është caktuar viti 2020 si viti që duhet të përfundojë ky proces me një tolerancë deri në dy vjet vetëm në rastet e justifikuara të lidhura kryesisht me çështje të koordinimit ndërkufitar.

Parashikimi sa më herët i prespektivës së përdorimit të këtij brezi në Shqipëri është mëse i nevojshëm për të orientuar investitorët, palët e interesuara për përdorimin e brezit si dhe për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare që kemi në kuadër të procesit të integritimit dhe respektimit të rregullimeve ndërkufitare për koordinimin e spektrit dhe shmangien e interferencave. Gjithashtu

përcaktimi i qartë i prespektivës së përdorimit është i nevojshëm për marrjen e masave rregullatore në përputhje me këto përcaktime.

Në Planin Kombëtar të Frekuencave të miratuar në mars 2017, është vendosur shënimi që brezi 694-790 MHz, është identifikuar për përdorim në të ardhmen për shërbime të lëvizshme me brez të gjerë, por nuk është përcaktuar një datë se kur kjo mund të ndodhë.

Ky plotësim është i nevojshëm dhe ndihmon procesin që duhet të ndërmarrin rregullatorët, AMA dhe AKEP si administratorë të spektrit civil si për trajtimin e çdo kërkesë të re për licensim në këtë brez, ashtu dhe për ndërmarrjen e amendimeve apo hapave teknike në licensat ekzistuese të dhëna në këtë brez.

Parashikimet e këtij neni janë të lidhura dhe me listën e aktiviteve të paraqitura në planin e veprimit.

Në nenet 10, jepet orientimi për plotësimin e nevojave të spektrit për politikën e komunikimeve të tjera pa tel (wireless) si shërbimet audiovizive, shërbimet e reja, apo ato inovatore duke shfrytëzuar komunikimet satelitore apo tokësore.

Në nenin 11, ka përcaktime për sistemet e monitorimit e të ruajtjes së atmosferës dhe të sipërfaqes së tokës, duke lejuar zhvillimin dhe shfrytëzimin e aplikacioneve hapësinore dhe përmirësimin e sistemeve të transportit, në veçanti për sistemin botëror satelitor të lundrimit civil të ngritur nga programi Galileo, për programin evropian të monitorimit të tokës (GMES), për sistemet inteligjente të mbrojtjes dhe të administrimit të transportit (ITS) dhe sistemet Evropiane të aviacionit, sipas praktikave të harmonizuara e të miratuara në nivel evropian.

Po ashtu në këtë nen orientohet që në spektrin e frekuencave përfshirë dhe atë të brezit 700 MHz, të planifikohet një sasi e mjaftueshme e spektrit radio për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve të lidhura me sigurinë publike dhe qarkullimin e lirë të pajisjeve të lidhura me to (PPDR), si dhe me zhvillimin e zgjidhjeve inovatore të ndërveprueshme për sigurinë dhe mbrojtjen publike, mbrojtjes civile dhe në rastet e ndihmës emergjente sipas rekomandimeve përkatëse evropiane. Ky parashikim plotëson dhe një kërkesë të paraqitur nga Ministria e Brendshme gjatë vitit 2019 në lidhje me sistemet e komunikimit për sigurinë publike (PPDR).

Në nenin 12, propozohet krijimi i një inventari të unifikuar të përdorimit aktual të spektrit të frekuencave nga AKEP, në bashkëpunim me AMA, Inventari do të jetë i unifikuar dhe i përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike. Kjo do t'i shërbejë planifikimit afatgjatë, identifikimit të brezave ku ka nevojë për përmirësim të efikasitetit si dhe vlerësimit të kërkesës për nevojat në të ardhmen, shmangies së fragmentizimit në administrimin e spektrit pasi aktualisht administrimi i spektrit për përdorim civil bëhet nga dy

institucionet AKEP dhe AMA dhe nuk ekziston një databazë e unifikuar. Neni parashikon gjithashtu nxjerrjen e një udhëzimi mbi aspektet praktike dhe formatin uniform të inventarit si dhe planifikimin nga rregullatorët të programeve (software) bashkëkohore për administrimin e spektrit sipas praktikave të mira rregullatore.

Neni 13, trajton çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar që është shumë i rëndësishëm dhe kritik në planifikimin dhe përdorimin e spektrit. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë. Shqipëria është anetare e ITU-se nga viti 1922 dhe ka detyrimin për përmbushjen e angazhimeve nga aktet kushtetuese të këtij organizmi. Rregullimi i spektrit të frekuencave në planin ndërkombëtar bëhet përmes Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU). Shqipëria bën pjesë në rajonin 1, sipas ndarjes globale së ITU. Për rregullimin e administrimin e harmonizuar në planin global dhe rajonal të spektrit të frekuencave hartohet Plani Kombëtar i Frekuencave. Plani Kombëtar i Frekuencave hartohet në përputhje me radio-rregulloret përkatëse të ITU-së dhe Tabelën për Përcaktimin e Përbashkët Evropian të Frekuencave (ECA). Praktikën e deritanishme në veçanti në rastin e transmetimeve numerike në brezin 800 MHz, gjatë procesit të tranzicionit është shoqëruar me probleme të interferencave ndërkufitare me Italinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut etj. duke u përcjellë si shqetësime dhe në rrugë diplomatike. Në procesin, kur shumë vende evropiane përfshirë dhe vendet fqinje kanë liruar spektrin e 700 MHz, dhe kanë parashikuar dhenien e saj për shërbime mobile broadband është e domosdoshme koordinimi ndërkufitar për shmangien e interferencave. Në këtë nen parashikohen marrëveshjet ndërkombëtare që duhet të realizohen për garantimin e përdorimit pa interferenca të spektrit ndërkufitar për të gjithë brezat e rëndësishëm.

Në nenin 14, jepet bashkëpunimi ndërinstitucional sipas parashikimeve aktuale në ligjin për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë. Si një risi në praktiken e deritanishme në këtë nen parashikohet dhe krijimi i një grupi këshillimor për çështjet e politikave spektrale.

Në nenin 15, jepet procesi i konsultimit në harmoni me legjislacionin për konsultimin publik dhe praktikën e mira rregullatore.

Në nenin 16, është parashikuar zbatimi dhe monitorimi. Mbi bazën e Urdhërit të Kryeministrit Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për Marrjen e Masave për Zbatimin e Qasjes së Gjërë Sektoriale/ndërsektoriale, si dhe Ngritjen dhe Funkcionimin e Mekanizmit Sektorial/Ndërsektorial të Integruar”, janë krijuar Grupet e Menaxhimit të Integruar të Programeve (“GMIP”) dhe Komitetet Drejtuese

Strategjike. Në dokument propozohet që zbatimin e monitorimin në nivel operacional ta ndjekë grupi tematik për telekomunikacionin dhe broadband të ngritur sipas këtij urdhri dhe në nivel strategjik KDS e Ndërlidhjes.

Neni 17, parashikon që dokumenti i politikave spektrale do të rishikohet periodikisht në varësi të zhvillimeve teknologjike dhe angazhimeve ndërkombëtare.

Në planin e veprimit janë parashikuar aktivitetet për zbatim bazuar në dokumentin e politikës së propozuar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohet për zbatimin e këtij projekt-vendimi janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Medias Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mbi bazën e diskutimeve dhe konsultimeve paraprake të kryera në nivel teknik me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare si dhe Autoritetin e Medias Audiovizive. Projekti u prezantua dhe gjatë takimit të grupit tematik të telekomunikacioneve dhe broadband të zhvilluar me datë 23.6.2020. Projektvendimi do t'i nënshtrohet konsultimit me grupet e interesit si dhe me institucionet.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-vendimi nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU